



**REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË**

VENDIM

Nr 19 Datë 04.03.09

**Për miratim fondi prej 144 000 Lekë për projektin për praktikën
sezonale të të rinjve në kuadër të projektit YEP**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Marketingut dhe Turizmit "Për miratim fondi prej 144 000 Lek për projektin për praktikën sezonale të të rinjve në kuadër të projektit YEP", në ligjin nr. 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 32 pika dh, Ligjin nr. 10025 dt. 27.11.2008 « Për buxhetin e vitit 2009 », Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 2, dt.12.01. 2009 « Për zbatimin e buxhetit të vitit 2009 », VKB nr. 12, dt. 13.02.2009, « Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të Bashkisë viti 2009, si dhe Ligji nr. 9936 dt. 26.06.2008 «Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë»".

VENDOSI:

1. Te miratoje fondin prej 144 000 Lek për projektin për praktikën sezonale të të rinjve në kuadër të projektit YEP.

2. Ky fond do të përballohet nga fondi rezervë i të ardhurave të Bashkisë me kete strukture buxhetore:

Pakesohet	00	01110	05	Art	6090000	- 144 000 Leke
Shtohet	00	01110	05	Art	6060000	+ 144 000 Leke

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Marketingut dhe Turizmit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Protokollit, Arkivës dhe Shërbimeve të tjera, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria Juridike.

4. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

KRYETAR

Raimonda NASE

Raimonda NASE